



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM I TRUPIT GJYKUES

“Mbi korrigjimin e gabimit material në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të dhënë për subjektin e rivlerësimit Erjon Bani, në datën 24.5.2021”

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopjeje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes, z. Roland Ilia, për korrigjimin e një gabimi material në numrin e vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani.

Pas verifikimit në regjistrin e numërimit të vendimeve, u konstatua se në faqen 1 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të dhënë në datën 24.5.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani, numri i aktit është shënuar gabimisht “390” dhe numri i vendimit është shënuar gabimisht “402”. Ndërkohë, numri i saktë i aktit është “402” dhe numri i saktë i vendimit është “390”.


Sa më sipër, duhet bërë korrigjimi dhe saktësimi në faqen 1 të vendimit, si vijon: Numri i aktit “390” të korrigjohet, duke u vendosur numri i saktë “402” dhe numri i vendimit të korrigjohet duke u vendosur numri i saktë “390”.

Trupi gjykues, pasi konstatoi se pasaktësia është e dukshme dhe si pasojë e një gabimi material gjatë shtypjes së vendimit në faqen e parë, vlerësoi se kërkesa e relatorit është e bazuar.

Për këto arsye,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

- 
1. Në faqen 1 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani, të datës 24.5.2021, të bëhet korrigjimi i numrit të aktit, duke e shkruar “402” dhe korrigjimi i numrit të vendimit, duke e shkruar “390”.
 2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe vëzhguesin ndërkombëtar për këtë korrigjim.
 3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

PAMELA QIRKO

KRYESUESE

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli

ROLAND ILIA

RELATOR

ETLEDA ÇIFTJA

ANËTARE

